



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1385/Prot.
P

Pogradec, më 28 / 03 . 2024

VENDIM

Nr. 35 , DATË 28 / 03 / 2024

Për një shtesë në Vendimin Nr. 23, datë 22.09.2019, “Për miratimin e linjave të transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve”.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 5; nenin 22, pika 1; neni 23, pika 6; neni 64, në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar; në VKM nr. 119, datë 01.03.2023 ”Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, pika 1 “Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e: a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri 50 km; b) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht)”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak :

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën në linjat e transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve si më poshtë:

Nr.	Linjat e transportit dhe iteneraret.	Distanca në km.	Kategoria e rrugës.				
			I	II	III	IV	V
1.	Lagjja Bibollari – Shkolla Velçan	2.2 km		0.8		1.4	
2.	Homçan - Proptisht	8.5 km				8.5	

2. Efekti i këtij ndryshimi është shërbimi i transportit të nxënësve të arsimit parashkollor.



3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Bashkia Pogradec dhe Zyra Vendore Arsimore Pogradec.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 24 vota

2.Vota Pro 24

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 29.03.2024